

BASHKIA DURRËS
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QERA

PËR DHËNIEN ME QIRA TË AMBJENTIT, ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 602 M² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 578 M² DHE SIP. FUNKS. 24 M²), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 10 VJET

1. Fillimi i procedurave për dhënien me qira të të ambjentit, me vendodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 602 m² (nga kjo sip. ndërtimi 578 m² dhe sip. funks. 24 m²), me vendodhje Lagja Nr. 17, Rruga “Neki Libohova”, pronë e Bashkisë Durrës.

2. Qëllimi i përdorimit të ambjentit së bashku me truallin funksional të tij është për ushtrimin e aktiviteteve të të gjitha llojeve për njësi prodhimi, të cilat nuk krijojnë ndotje sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

3. Çmimi dysheme i fillimit të konkurrimit është 117,000 (njëqindeshtatëmbëdhjetëmijë) lekë/muaj, e përllogaritur kjo sipas VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

4. Afati i dhënies me qira do të jetë 10 (dhjetë) vjet.

5. Pikët vlerësuese do të jenë:

Niveli i investimit	10 pikë
Niveli i punësimit	40 pikë
Oferta e detyrimit mujor	30 pikë
Kontrata të ngjashme	20 pikë

6. Tërheqja e dokumentacionit të nevojshëm do të bëhet në zyrën e caktuar nga bashkia për pronat publike.

7. Dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët për marrjen me qira do të jetë si më poshtë:

a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë së Bashkisë Durrës, ku të deklarohet oferta për

vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.

b) Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;
- Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i

burimeve financiare të investimit;

- Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat

e përcaktuara të realizimit të tij;

- Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara;

- Një përshkrim i hollësishëm të planit të biznesit.

c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit (bashkëlidhur), si më poshtë vijon:

- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues;

- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;

- Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse

ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

d) Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore,

deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte

shtetërore.

dh) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar

në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

8. Paraqitja e dokumentacionit do të kryhet pranë bashkisë Durrës, kati i tretë, salla e mbledhjeve, me

datë 30.06.2020, ora 10⁰⁰.